



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**  
**Morfologji e Gjuhës B**

**Ngarkesa:** 4 kredite, 20 orë leksione; 20 orë seminare

**Viti /Semestri :** Viti II, semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Ky kurs synon: Të zhvillojë aftësinë e të reflektuarit dhe të argumentuarit në fushën e gramatikës (morfologjise) së gjuhës spanjolle. Është lëndë e detyrueshme, e cila ofrohet si formim bazik gjuhësor për studentët e gjuhës spanjolle në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë. Rekomandohet që studenti të zotërojë kompetencë komunikimi në gjuhën spanjolle dhe të zotërojë njohuri gramatikore mbi këtë gjuhë.

*Objektivat specifike lëndore:*

1. Të pajisë studentët që specializohen në fushën e gjuhësisë spanjolle, me nocionet themelore të morfologjisë së gjuhës spanjolle dhe me tipologjinë kryesore të sistemit të saj. Objektivi i kursit është që studenti të zhvillojë aftësinë e tij të reflektimit dhe të argumentimit në fushën e morfologjise së spanjishtes.

2. Të njohë në thellësi aspektet formale me të rëndësishme të fjalës si dhe të zgjerojë njohuritë për gramatiken e spanjishtes duke filluar nga aspektet e saj morfologjike për një analizë gramatikore dhe semantike.

3. Të arrijë të përvetësojë dhe të zhvillojë aftësinë e të analizuarit dhe të komentuarit të teksteve dhe dokumentave të ndryshëm në fushën morfologjike të kësaj gjuhe.